



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

PROCESVERBAL

Mbledhja e datës 27.12.2024

I mbajtur sot me datë 27.12.2024, ora 11:00, në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak. U zhvillua mbledhja e radhës e këshillit, sipas njoftimit të datës 17.12.2024. Në mbledhje morën pjesë: A.M, S.M, A.Z, D.S, E.B, V.M, A.C, M.K, F.G, H.E, A.G, A.C, B.B, V.B, Xh.V, A.D, R.T, G.H, H.P, B.LI, A.S, F.S, G.Sh, A.Sh, E.Gj.

Kryetari i këshillit lexon rendin e ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës **02.12.2024**.
2. **Projektvendim** “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, **Nëntor 2024**”.
3. **Projektvendim** “ Për shpërndarjen e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2024-2025 (nxënësit e klasave 10, MAS”.
4. **Projektvendim** “ Për shpërndarjen e bursave për nxënësit e vitit të parë (klasa 10) të arsimit të mesëm professional në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2024-2025”.
5. **Projektvendim** “ Për rishqyrtimin e bursave për arsimin e mesëm në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2024-2025”
6. **Projektvendim** “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës për vitin 2025”.
7. **Projektvendim** “ Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin **2025**”.
8. **Projektvendim** “ Për miratimin e kalendarit të aktiviteteve të programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”.

9. **Projektvendim** “Për ndryshimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të draftit final të Programit Buxhetor Afatmesëm **2025-2027**”.
10. **Projektvendim** “ Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 sipas SMBV”.
11. **Projektvendim** “ Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Kukës për vitin 2025 sipas SMBV”
12. **Projektvendim** “ Për miratimin e planit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike **2024-2040**”

Të ndryshme (Caktimi i datës së zgjedhjeve për 1 anëtar kryesie në fshatin Mustafaj, etj).

Para miratimit të rendit të ditës , z. F.G:

Kam kërkuar që si pikë e rendit të ditës të jetë informacioni për gjendjen e infrastrukturës.

A.M: Ky informacion ka ardhur sot në këshill bashkiak.

A.H: Është mbledhja e fundit e Këshillit Bashkiak . Të gjitha palët janë njohur në vazhdimësi me procesin e buxhetimit. Ne kemi respektuar të gjitha fazat e buxhetit ku më kryesorja është konsultimi publik. Lidhur me planin e investimeve , kopshti nr 3, shkolla “Avni Rustemi”, rruga e Topojanit, sinjalistika rrugore, blerje makineri zjarrfikëse. Janë hartuar projektet për shërbim projektim, rikonstruksion I shkollës “Elmaz Ademi”, muzeu, një segment i rrugës Shtiqën, KUZ.

Pagat e këshilltarëve do të rriten në nivel maksimal ashtu si dhe pagat e disa funksioneve kryesore, drejtoritë kryesore në bashki dhe disa pozicione kyçe.

Do të bëhet rikonstruksion i godinës së bashkisë si dhe një sallë dinjitoze për mbledhjet e këshillit.

Ju shpreh mirënjohjen për angazhimin dhe mbështetjen tuaj gjatë gjithë vitit. Lidhur me kërkesën e z. F.G Ne jemi përpjekur në maksimum për menaxhimin e situatës. Jemi në kontakt dhe gadishmëri për të ndërhyrë në çdo moment.

F.G: Cili është prioriteti kryesor i bashkisë? Prioritetet duhet të vijnë në këshill, si rregull.

A.H: Kemi 34 projekte prioritare. 7 prej tyre janë të financuara. Presim financime të tjera. Nuk po përmendim financimet që po bëhen nga fondi shqiptar i zhvillimit.

Miratohet rendi i ditës me shumicë votash.

1. Shqyrtohet pika 1, miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 02.12.2024. Miratohet.

A.G: Duhet të zgjidhet problemi i hyrjes në Kukës.

2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, **Nëntor 2024**”.

G.H: Projektvendimi është konform ligjeve. Komisioni ra dakord që të kalohet në këshill pa ndryshime. Hidhet në votim. Miratohet me të gjitha votat pro.

3. Projektvendim “ Për shpërndarjen e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2024-2025 (nxënësit e klasave 10, MAS”.

F.G: Projektvendimet janë kaluar në komision. Kishim një vërejtje, sjelljen me vonesë të materialeve. Janë mbuluar 100% kërkesat. Kam kërkuar rritje të kapaciteteve të kopshteve dhe cerdheve me drekë. Hidhet në votim. Miratohet me të gjitha votat pro.

F.G: Mospërfshirja e sportistëve elitare nuk është e drejtë. Ne jemi për të stimuluar., nxitur, etj.

A.H: Lidhur me shqetësimin e profesorit, kam pas kontakt me S. P. Kemi kërkuar ndryshime me strukturën e re.

4. Projektvendim “ Për shpërndarjen e bursave për nxënësit e vitit të parë (klasa 10) të arsimit të mesëm profesional në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2024-2025”. Miratohet me të gjitha votat pro.

5. Projektvendim “ Për rishqyrtimin e bursave për arsimin e mesëm në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2024-2025”. Miratohet me të gjitha votat pro.

A.G: Si aleancë e grave këshilltare kemi marrë një nismë që nënat kryefamiljare që kanë fëmijë në kopshte dhe cerdhetë përjashtohen nga pagesa e tarifës.

A.H: Do të reflektohet në buxhetin e vitit 2025.

6.Projektvendim “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kukës për vitin 2025”.

S.M: Projektvendimi është shqyrtuar në mbledhjen e komisionit, të zhvilluar me datë 24. U konstatua që ka vetëm 2 ndryshime: heqjen e taksës së peshkimit dhe të therjes.

Komisioni propozoi që të bëhet një ndryshimte tarifa e parkimit, **nëse subjekti lidh kontratë për 2 vende parkimi, t’i jepet një falas.**

F.G: Projekti duhej të sillej i përmirësuar sipas kërkesës së komisionit drejtuar drejtorisë përkatëse. Ne si anëtarë të këshillit kemi kërkuar shifra. Shqetësimi më i madh i komunitetit është shpopullimi. Ne kemi biznese që në fakt janë si salla pensionistash. Duhet të operohet me ndarjen e parkingjeve, sidomos lagjet 4, 5, 6. Rrugët në lagje të re, duhet të jenë prioritet. Gjithashtu, kërkohet ujë i pijshëm, ujë vaditës, etj.

A.H: Lidhur me parkimin, ndër prioritetet e 2025 është sinjalistikës për të gjithë qytetin. Kjo do të zgjidhë përfundimisht problemin e trafikut.

Do të implementohet paketa e maleve që do të bëjë të mundur akordimin e fondeve për njësitë administrative. Bashkia do të ngrijë një grup pune për këtë çështje. Po presim projektin për lagjen e re. Do të bëjë të pamundurën për infrastrukturën e kësaj lagjeje.

A.D: Kur është bërë dëgjesa publike për paketën fiskale dhe kur është njoftuar?

P.G: Me datë 13 dhjetor.

A.D: Më thuaj ligjin ku jeni mbështetur për tarifatat e përkohshme.

A.H: Të gjitha taksta dhe tarifatat janë vendosur sipas ligjit.

P.G: Janë mbështetur në ligjin 9920.

A.H: A ka konflikt interesi. Bashkia ka vendosur taksën për HEC-et vite më parë.

Është e përcaktuar te ligji për taksat vendore.

A.Sh: Jemi përfaqësues të shoqatës AREA. Që nga viti 2020 ka ndodhur një ndryshim rrënjësor te taksat e hidrocentraleve. Është vendosur një tarifë për mbrojtjen e mjedisit. Ne paguajmë një tarifë sipas kontratës koncesionare. Ne paguajmë taksa për rrogat tuaja.

M.K: Cfarë biznesi keni ju?

-Energji e rinovueshme.

Avokatja e Shoqatës: A mund të marr fjalën?

A.M: Ju jeni në një process ligjor me bashkinë Kukës. Duhet të shprehen gjykatat.

Avokatja: Duhet të tregoni respekt për pozicionin që përfaqësoni. Ne nuk kemi asnjë njoftim për konsultim publik. Ne po kërkojmë për një të mirë publike. Cfarë keni bërë ju për të përmirësuar dhe mbrojtur mjedisin me të ardhurat që merrni nga kjo tarifë e vendosur për HEC-et?

A.G: Po ju vë në dijeni që në një vit electoral nuk mund të bëhen ndryshime të taksave dhe tarifave. Paketa fiskale e 2025 është e njëjtë me paraardhësen.

Hidhet në votim. Miratohet me 20 vota pro dhe 3 abstenim.

Projektvendim “ Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2025”.

Projektvendim “ Për miratimin e kalendarit të aktiviteteve të programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026”.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financës ka shqyrtuar dhe ka vendosur me shumicë votash të miratojë buxhetin e këshillit, kalendarin e aktiviteteve, tavanet përfundimtare të shpenzimeve, Hidhet në votim buxheti i këshillit bashkiak. Miratohet me 3 abstenim.

Hidhet në votim kalendar i aktiviteteve të PBA 2026-2028. Miratohet .

A.M largohet nga mbledhja.

Projektvendim “Për ndryshimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të draftit final të Programit Buxhetor Afatmesëm **2025-2027**”. **Miratohet.**

Projektvendim “ Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 sipas SMBV”.

S.M: Edhe ky projektvendim ka kaluar në komision. Hidhet në votim. Miratohet.

Projektvendim “ Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Kukës për vitin 2025 sipas SMBV”

S.M: Është kaluar në komision.

F.G: 60% e buxhetit shkon për paga dhe sigurime. Të punonjësve. Duhet të shikohet struktura e punonjësve, të ulet numri, të stimulohet specialisti me pagë, etj.

Hidhet në votim. Miratohet me 19 vota pro.

Projektvendim “ Për miratimin e planit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike **2024-2040**”

Nuk ka diskutime. Miratohet me të gjitha votat pro.

Diskutohet për zgjedhjen e anëtarit të kryesisë për fshatin Mustafaj. Vendoset të bëhen zgjedhjet në janar.

Lidhur me kthimin e vendimit për ngritjen e komisionit të përkohshëm, këshilli bashkiak vendos të pranojë argumentet e paraqitura nga kryetari i bashkisë.

Mbyllet mbledhja. Firmoset procesverbali i mbledhjes.

Kukës, datë 27.12.2024

SEKRETARI I KËSHILLIT

Eridona RAMALLARI



KRYETARI I KËSHILLIT

Albert MUJA